



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VI**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 20.12.2018, me fillim në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-302

**PROCESVERBALI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Duda Balje, Slobodan Petroviç dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Igor Simiq, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavjeviç dhe Zoran Mojsiloviç.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic OSBE; Pleurat Kurti EUSR; Hajrudin Skënderi Ambasada e Suedisë; Ndrëçim Çekaj KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur me datë: 30.11.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me raport amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës me raport amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit me raport amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
6. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Zëvendëskryetari, Xhelal Sveçla**, në mos praninë e Kryetarit të Komisionit, Igor Simiq, kam ftuar mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me datë 20.12.2018, duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 1, nenin 64 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe me Vendimin e Kuvendit të Kosovës nga data 25.10 dhe 02.11.2018, me arsye të përshpejtimit dhe miratimit të projektligjeve.

Në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, komisioni duhet t'i shqyrtojë brenda afatit të caktuar projektligjet, si në vijim.

Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me raport amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës me raport amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit me raport amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi propozimin e pikëve të rendit të ditës, me qëllim të shqyrtimit të projektligjeve dhe të paraqes raport me rekomandime, të cilat do ti procedojë për miratim në komisionet funksionale.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur me datë: 30.11.2018.**

*Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30.11.2018, pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me raport amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës me raport amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

**R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit me raport amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

**R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**6. Të ndryshme.**

**Zëvendëskryetari**, i njoftoi anëtarët se në mbledhjen e kaluar, komisioni ka dalë me deklaratë, me ç' rast ka dënuar ashpër ndalimin e jashtëligjshëm të deputetit z. Slobodan Petroviq, nga ana e policisë Serbe në kufirin Kosovë – Serbi.

Mes tjerash, tha se më datë 20.12.2018, Komisioni ka pranuar informatën nga ana e Policisë së Kosovës nr. 01/1235 të datës 19.12.2018, lidhur me ndalimin e deputetit të Partisë liberale serbe dhe anëtar i komisionit z. Slobodan Petroviq, nga xhandarmeria e Serbisë, në kufirin Kosovë – Serbi, përkatësisht në kalimin kufitar Merdare dhe procedurave të ndërmarra operative standarde për mbrojtjen e sigurisë së z. Petroviq dhe familjes së tij.

Në arsyetimin e lajmërimit nga Policia e Kosovës theksohet: se z. Slobodan Petroviq ka deklaruar se nuk dëshiron mbrojtjen e Policisë së Kosovës, si dhe se ka refuzuar vazhdimin e procedurave për vlerësimin e rrezikshmërisë.

Më pas, në këtë informatë, NJVKRR si preventivë ka dhënë disa rekomandime, për sigurimin e z. Petroviq dhe familjes së tij

**Slobodan Petrovic**, fillimisht falënderoi Komisionin, i cili ka dalë me deklaratë, që të dënohet ndalimi im nga policia serbe, me rastin e kalimit të kufirit Kosovë – Serbi , me datë 8.12.2018

Theksoi se personalisht e kam pranuar të njëjtën shkresë nga ana e policisë së Kosovës. Me rastin e kontaktit me IPPO, kam deklaruar se do të respektoj çdo lloj të vlerësimit të rrezikshmërisë, por jo në kuptim të asaj se nuk dëshiroj mbrojtjen policore. Sipas të gjitha gjasave, bëhet fjalë për një keqkuptim apo mund të thuhet se nuk është kuptuar drejtë rëndësia e rastit gjatë komunikimit të të dy palëve. Përkundrazi, është më se e nevojshme të kam mbështetjen e policisë së Kosovës me qëllim të sigurimit tim dhe familjes time .

*Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:*

### ***Përfundim***

*U morr qëndrim që në formë të shkruar ti drejtohem policisë së Kosovës për të ndërmarr hapat e nevojshëm, me qëllim që t'ju garantohet siguria e z. Slobodan Petroviq dhe familjes së tij*

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

**Zëvendëskryetar i komisionit,**

---

**Xhelal Sveçla**